



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-031

Prishtinë, më 6 shtator 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 6 SHTATOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE: Floriana Shala dhe

Nga NDI, Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 24 dhe 29 gusht 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 24 dhe 29 gusht 2011

Procesverbalet t mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 24 dhe 29 gusht 2011, u miratuan pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me këtë pikë, konstatoi se data e mbajtjes dhe caktimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës do të caktohet në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë së Kuvendit.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Administratës së Kuvendit për ridestinimin e projekteve kapitale në buxhetin e Kuvendit të Kosovës, për vitin 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

I. Kërkohet nga Ministri i Financave që të autorizojë transferin e mjeteve buxhetore të projekteve kapitale në Buxhetin e Kuvendit të Kosovës për vitin 2011, si në vijim:

Transferimi i mjeteve buxhetore nga projektet kapitale:

- Blerja e automjeteve për nevoja të Kuvendit, në shumë prej 130,000€, dhe
- Rregullimi i rrethojave në ndërtesën e Kuvendit, në shumë prej 65,000€,

Në Projektin kapital: Rinovimi dhe mobilimi i Aneksit të Kuvendit.

3.2 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e shpenzimeve të Kuvendit, për gjashtëmujorin e vitit 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

Miratohe

t Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për gjashtëmujorin e vitit 2011, sipas pasqyrave të paraqitura në këtë raport.

3.3 Informatë lidhur më Projektin e Binjakëzimit: “Mbështetje për Kuvendin e Republikës së Kosovës”, të financuar nga Komisioni Evropian

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, njoftoi Kryesinë lidhur me Projektin e Binjakëzimit: “Mbështetje për Kuvendin e Republikës së Kosovës”, të financuar nga Komisioni Evropian. Ky Projekt ka për qëllim të ngrejë kapacitetet e administratës së Kuvendit, në dy aspekte: a) të përmirësojë kapacitetin administrativ për mbështetjen e Kryesisë së Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare për t’i përmbushur detyrat e tyre, dhe b) të ngrejë kapacitetet në Administratë lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, si dhe me praktikat më të mira të BE-së për përmbushjen e detyrave administrative. Projekti fillon në nëntor të këtij viti dhe do zgjasë dy vjet.

Tani është gati Projekt-kontrata për fillimin e këtij projekti, i cili përbëhet prej nëntë komponentëve. Kryesia e Kuvendit do të njoftohet në mënyrë periodike, në çdo tre muaj, për mënyrën e zbatimit të këtij projekti.

3.4 Kërkesa e Këshillit Organizativ “Drejtësi në Rastin Kiçina” për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme lidhur me rastin ”Kiçina”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtoj kërkesën e Këshillit Organizativë “Drejtësi në Rastin Kiçina” dhe lidhur me të ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit.

3.5 Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit për zëvendësimin e makinës zyrtare

Kryesia miratoi kërkesën e nënkryetari të Kuvendit z. Glauk Konjufca, për t’ia vënë në dispozicion një makinë zyrtare të Kuvendit, sipas kërkesës së tij.

3.6 Kremtimi i Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kryesia miratoi kërkesën që në kuadër të kremtimit të Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë t’u lejohej përfaqësuesve asociacionit të të rinjve nga të gjitha komunat e Kosovës shfrytëzimi i sallës së seancave plenare të Kuvendit për simulimin e një seance plenare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:25** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.